

REPUBLIKA E KOSOVËS / RIJAHUJANA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia Org. Org. Unit Nr. i Faqeve Nr. Stranica No. Pages	Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No. Data Datum Date
SP-02 -04-	4508-2/24 29.07.21 PRISHTINË / A No. 1



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
 Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
 Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	26.05.2025
REFERENC-Ë:	24/4508/MMPHI
PËR/ZA/TO:	Company "Bejta Commerce" Sh.A., Gjilan Ekspluatim i gurit gëlqeror, Gllamë, Gjilan
C.C.	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për pajisje me Leje Mjedisore të operatorit Company "Bejta Commerce" Sh.A., Gjilan me nr. prot. 24/4508/MMPHI, për veprimtarinë: Ekspluatim i gurit gëlqeror në, Gllamë, Gjilan.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr. 24/4508/MMPHI
Datë: 26.05.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi, 1, 2 dhe 4 të nenit 12, neni 17, paragrafi 2 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatori Company "Bejta Commerce" Sh.A., Gjiilan me nr. prot. 24/4508/MMPHI, pajiset me Leje Mjedisore për veprimtarinë: Eksploatim i gurit gëlqeror, në pjesët e ngastrave nr. 1261/1 dhe nr. 1723/1 zona kadastrale, Gllamë, Gjiilan.
2. Operatori obligohet:
 - 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
 - 2.2. Të mirëmbahet thurja e ngastrës ku bëhet shfrytëzimi i gurit gëlqeror;
 - 2.3. Të i përmbahet kushteve të shfrytëzimit të gurit gëlqeror sipas përshkrimit në aplikacion;

- 2.4. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit mjedisor që është përgjegjës për mjedis;
- 2.5. Vazhdimisht të behët spërkatja me ujë e rrugëve të pa asfaltuara të cilat shfrytëzohen për bartjen e gurit gëlqeror;
- 2.6. Pas përfundimit të aktivitetit të bëhet rehabilitimi dhe rikultivimi i zonës sipas kriterëve ligjore dhe përshkrimit në aplikacion;
- 2.7. Nëse gjatë operimit do të këtë ndonjë prishje teknike e që mund të këtë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin Company "Bejta Commerce" Sh.A.,Gjilan me nr. prot. 24/4508/MMPHI, për veprimtarinë: Eksploatim i gurit gëlqeror, në pjesët e ngastrave 1261/1 dhe nr.1723/1zona kadastrale, Gllamë, Gjilan, MMPHI konstaton se operatori plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për vazhdimin e Lejes Mjedisore.

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit-ARBK;
- Pëlqimit Mjedisor me Nr. 17/2330/1-ZSP/124/17, të lëshuar me datë:16.05.2017;
- Licencë për shfrytëzimin e gurit gëlqeror, Nr. Prot. 776, me nr. licensës, 1793/KPMM/2018, me afat gjerë me: 02.07.2031.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet administrative dhe mjedisore dhe merr **Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.**

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

U.D. Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës Gjilan;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së